

# OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

# 17 DHJETOR 2023

## Përmbledhje e pikave kryesore



### Kërcënim ndaj sigurisë: Si përfitojnë kriminelët nga sfidat politike të Kosovës.

Pavarësisht tri përpjekjeve për anëtarësim, Kosova nuk është anëtare e INTERPOL-it për shkak të marrëdhënieve jo të mira me Serbinë. Kosovën e kanë kritikuar se nuk po bën përpjekje të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar, por kjo luftë pengohet nga mungesa e qasjes në informacione dhe në operacione të përbashkëta që lehtësohen nëpërmjet këtyre organeve ligjzbatuese ndërkombëtare dhe rajonale. Duke qenë se organizatat kriminale kërkojnë "parajsë sigurie" në vendet ku zbatimi i ligjit është i dobët, fuqizimi i kapaciteteve të Kosovës për të zbatuar ligjin dhe për të vepruar me shpejtësi me qëllim trajtimin e krimit ndërkufitar mund të ndihmojë me uljen e normës së krimit në rajon.



### A është nxjerrë ndonjë mësim në lidhje me menaxhimin e valës së re të emigracionit në vendet e Ballkanit Perëndimor?

Numri i refugjatëve dhe i emigrantëve që udhëtojnë përmes Ballkanit Perëndimor është më i larti që prej vitit 2015. Krahasuar me shtatë vjet më parë, po

shfaqen prirje të reja në lidhje me kontrabandimin e emigrantëve nëpërmjet rrugës ballkanike: rrjetet duket se janë përshtatur më shumë dhe janë bërë të decentralizuara, pjesërisht për shkak të përdorimit të teknologjisë. Më tej, duket se ka ndryshuar edhe profili i kontrabandistëve, meqë tregu tani ka marrë përmasa më ndërkombëtare. Përpjekjet për ta penguar emigrimin nga këto vende të Ballkanit Perëndimor dhe shtete anëtare të BE-së, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, duhet të përqendrohen te zbutja e faktorëve nxitës që i shtojnë emigrantët të vënë jetën e tyre në rrezik në kërkim të një jete më të mirë.



### Rreziqet në burgje mund të ndikojnë për keq te lufta kundër krimit në Ballkanin

#### Perëndimor.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë norma relativisht të larta të popullatës së burgjeve krahasuar me shtetet e tjera të Evropës. Në teori, burgjet duhet të jenë institucione korrektimi dhe vendi i fundit i shkallëve të krimit. Në realitet, burgjet, në shumë raste, janë shkolla të shkëlqyera ku rekrutohen autorët e veprave penale të lehta, për t'i bërë ata pjesë të krimit të organizuar,



nyja të rrjeteve dhe mbështetës të fshehtë për realizimin e veprimtarive kriminale. Pa reformë, ekziston rreziku që burgjet në Ballkanin Perëndimor ta

përkeqësojnë, në vend që ta përmirësojnë, problemin e krimit të rëndë të organizuar në rajon.

# Kërcënim ndaj sigurisë: Si përfitojnë kriminelët nga sfidat politike të Kosovës.

Këtë nëntor, Asambleja e Përgjithshme e INTERPOL-it festoi zyrtarisht në Vjenë, edhe pse pak vonë, 100-vjetorin e policisë së botës, ku u themelua në shtator të vitit 1923. Por Kosova nuk mori pjesë. Përpjekjet e shumta për t'u anëtarësuar në organin kryesor të botës që lufton kundër krimit janë bllokuar nga shtetet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Këtë vend e kanë penguar edhe që të bëhet pjesë e disa organeve ligjzbatuese të tjera rajonale dhe evropiane, edhe pse, në disa raste, Kosova ka arritur të lidhë marrëveshje pune.

Nga nëntë agjencitë kryesore ligjzbatuese, kufitare dhe gjyqësore, në të cilat vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor mund të bëhen anëtare ose me të cilat mund të bashkëpunojnë, Kosova është anëtare në vetëm dy prej tyre (shihni figurën 1). Rezultati paradoksal është se Kosova kritikohet se nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar, edhe pse, pjesërisht, pengohet nga mungesa e qasjes në informacione dhe nga operacionet e përbashkëta që realizohen nëpërmjet punës së këtyre organizatave.

Policia e Kosovës është agjenci relativisht e re e zbatimit të ligjit. Ajo është themeluar në shtator të vitit 1999, me përkrahjen e komunitetit ndërkombëtar, në veçanti të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Ajo ka vepruar nën mbikëqyrjen e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) deri kur shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008. Që prej asaj kohe, kapacitetet e Policisë së Kosovës janë ngritur në mënyrë të konsiderueshme.<sup>1</sup>

Megjithatë, aftësia e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar është e kufizuar, sepse Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe pesë shtete anëtare të BE-së – Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qiproja – nuk e njohin Kosovën si shtet. Në fakt, Kosova nuk ka arritur tri herë që të fitojë mbështetjen e dy të tretave të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it. Sigurimi i kësaj mbështetjeje është i domosdoshëm për t'u anëtarësuar në këtë organizatë.<sup>2</sup> Pas përpjekjes së fundit në nëntor të vitit 2018, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, e konsideroi këtë dështim si "fitore" për vendin e tij, pasi kishte nisur më përpara një fushatë kundër

ORGANIZATA	KOSOVA	VENDET E TJERA TË BALLKANIT PERËNDIMOR
<b>INTERPOL</b>	• Nuk është shtet anëtar	• Shtete anëtare
<b>EUROPOL</b>	• Marrëveshje pune	• Marrëveshje strategjike dhe operative
<b>EUROJUST</b>	• Nuk ka marrëveshje	• Marrëveshje bashkëpunimi
<b>FRONTEX</b>	• Marrëveshje pune	• Marrëveshje pune
<b>Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC)</b>	• Nuk është shtet anëtar	• Shtete anëtare
<b>Njësia për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit (ILECU)</b>	• Shtet anëtar	• Shtete anëtare
<b>Shoqata e Shefave të Policisë të Evropës Juglindore (SEPCA)</b>	• Nuk është shtet anëtar	• Shtete anëtare
<b>Konventa e Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore (PCSEE)</b>	• Nuk është shtet anëtar	• Shtete anëtare
<b>Nisma Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI)</b>	• Shtet anëtar	• Shtete anëtare

**FIGURA 1** Marrëdhënia e Kosovës me nëntë organizatat kufitare dhe ligjzbatuese krahasuar me simotrat e saj të Ballkanit Perëndimor.

Burimi: Faqet zyrtare të organizatave të cituara.

pranimit të kërkesës së Kosovës për anëtarësim. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë theksuar se anëtarësia e Kosovës në INTERPOL “nuk ka pasur të bëjë kurrë me njohjen e pavarësisë së Kosovës, por me fuqizimin e bashkëpunimit global në fushën e zbatimit të ligjit dhe me mbylljen e një hendeku vendimtar të sigurisë në Ballkan”.<sup>3</sup>

Që prej vitit 2002, Kosova ka komunikuar tërthorazi me INTERPOL-it nëpërmjet një zyre të dedikuar të ndërlidhjes të UNMIK-ut,<sup>4</sup> e cila në fillim punoi me Ministrinë e Drejtësisë dhe, nga fundi i vitit 2016, me Policinë e Kosovës. Në të vërtetë, kjo zyrë e ndërlidhjes ka marrë përsipër rolin e një “byroje qendrore kombëtare”.<sup>5</sup>

Ky komunikim i tërthortë – i gërshetuar me kufizimet që i janë imponuar Zyrës së OKB-së për Ndërlidhjen përballë rolit të byrosë qendrore kombëtare – rezulton në bashkëpunim të ngadaltë dhe të kufizuar me INTERPOL-in (shihni figurën 2). Ndërkohë që një shteti anëtar i duhen nga dy orë deri në dy ditë që të japë një njoftim të kuq në

databazën e INTERPOL-it,<sup>6</sup> Kosovës, në përgjithësi, i duhen nga nëntë deri në dymbëdhjetë muaj dhe, ndonjëherë, deri në dy vjet, për të njëjtën gjë. Sipas një burimi të Policisë së Kosovës, vonesat shkaktohen edhe nga mungesa e stafit të Zyrës së Ndërlidhjes dhe nga proceset burokratike brenda OKB-së.<sup>7</sup>

Ndërkohë, Kosovës i duhen po ashtu midis nëntë deri në dy vjet që të nxjerrë “difuzione” (lajmërimë), megjithatë, kur bëhet fjalë për shtetet anëtare, këto lajmërimë iu qarkullohen menjëherë dhe pa vonesa (të gjitha shteteve anëtare ose disa prej tyre).<sup>8</sup> E gjithë kjo situatë i jep një personi që kërkohet nga autoritetet e Kosovës disa muaj kohë për të kapërcyer disa kufij dhe për t’i shpëtuar drejtësisë.

Shkëmbimi i ngadaltë i informacioneve të ngutshme bëhet edhe më i ngadaltë për shkak të mungesës së qasjes së drejtpërdrejt të 19 databazat e INTERPOL-it. Këto databaza përmbajnë shumë të dhëna, nga lajmërimet për të arratisurit dhe kriminelët e dyshuar, deri te gjurmët e

FUNKSIONI	ZYRA E UNMIK-UT PËR NDËRLIDHJEN ME INTERPOL-IN	SHTET ANËTAR I INTERPOL-IT
<b>Byroja Qendrore Kombëtare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punon nga e hëna në të premte, nga ora 08:00 deri në orën 16:00</li> <li>Pjesë e strukturës së UNMIK-ut, e veçuar nga Policia e Kosovës</li> <li>Në nivelin kombëtar bashkëpunon vetëm me Policinë e Kosovës (lehtëson shkëmbimin e informacionit me INTERPOL-in)</li> <li>Nuk ka qasje në databazat kombëtare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punon 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës</li> <li>Zakonisht pjesë e forcave policore</li> <li>Në nivelin kombëtar, bashkëpunon me agjencitë e tjera ligjzbatuese</li> <li>Ka qasje të drejtpërdrejtë në databazat kombëtare</li> </ul>
<b>Komunikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistem i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të sigurt me INTERPOL-in, por komunikimi me Policinë e Kosovës kryhet nëpërmjet postës elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistem i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të sigurt me INTERPOL-in</li> </ul>
<b>Databazat kriminale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Policia e Kosovës nuk mund të bëjë kërkime në databaza në kohë reale, por vetëm në bazë të kërkesave që i parashtron nëpërmjet UNMIK-ut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Policia kombëtare mund të bëjë kërkime në të 19 databazat e INTERPOL-it në kohë reale, në kuadër të hetimeve të saj</li> </ul>
<b>Kontrollet kufitare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Databaza kufitare e Policisë së Kosovës nuk është e lidhur me Zyrën e UNMIK-ut për Ndërlidhjen me INTERPOL-in dhe me INTERPOL-in. Është e pamundur të zbulohen në kufij të arratisurit, kriminelët e dyshuar dhe dokumentet false.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Autoritetet kufitare kombëtare janë të lidhura drejtpërdrejt me databazat e INTERPOL-it dhe mund të zbulojnë në kufij të arratisurit, kriminelët e dyshuar dhe dokumentet false.</li> </ul>
<b>Përfshirja e lajmërimeve të kuqe</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zakonisht zgjat nga 9 deri në 2 vjet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nga 2 orë deri në 2 ditë</li> </ul>
<b>Difuzionet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E njëjta procedurë si në rastin e lajmërimeve të kuqe (9 muaj deri në 2 vjet)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>I qarkullohen drejtpërdrejt dhe në kohë reale byrosë qendrore kombëtare të shtetit anëtar (disa ose të gjitha shteteve anëtare)</li> </ul>

**FIGURA 2** Protokollet e komunikimit të Kosovës me INTERPOL-in (majtas) dhe protokollet e komunikimit të shteteve anëtare me INTERPOL-in (djathtas).

Burimi: INTERPOL-i, intervistë me një oficer policie.

Vendi	Serbia		Spanja		Bosnja dhe Hercegovina		Sllovakia		Greqia		Rumania		Qiproja	
	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës	Hyrës	Dalës
Lloji i informacionit														
Krimet kundër personit	33	27	2	4	2	2	7	6	3	2	4	1		
Krimet kundër pronës	15	6	3	2	3		8	4	6	5	1			
Trafikimi i drogës	15	4	1		1	1			3	1				
Krime kundër automjeteve	51	41	6	7	6	1	1	1			1			
Falsifikimi	36	22	5	4	2	4	2		2	4	5			
Krimi ekonomik	4	4	3	3		1			4	4				
Krimi financiar	12	2	3		14	5	1		1		5	4	2	2
Armët e zjarrit	19	5	10	1			1					1		
Trafikimi i njerëzve	7	5			2	1	4	2			2			
Krime kundër integritetit seksual	2	1												
Terrorizmi	1	1							1					
Personat e humbur	27	5							1		4			
Krimi kibernetik	2	2	3	5	5	2	1		4	3				
Krimi kufitar	11	10					7	6	3		1			
Të tjera	7	11			3	1	3	1	3		2	2		

**FIGURA 3** Numri dhe fusha e shkëmbimit të informacionit policor me vendet "që nuk e njohin Kosovën" (nga 1 janari 2021 deri më 20 korrik 2023).

Burimi: Policia e Kosovës.

gishtave, ADN-ja dhe të dhënat për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit. Po ashtu, INTERPOL-i ka një databazë që i kushtohet vetëm krimet të organizuar.<sup>9</sup> Mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë të të dhënat, në lidhje me personat e shpallur në kërkim – dhe në lidhje me dokumentet e vjedhura<sup>10</sup> – u mundëson kriminelëve, terroristëve dhe të arratisurve që të hyjnë në Kosovë pa u zbuluar nga autoritetet kufitare.<sup>11</sup>

Disa prej mangësive të bashkëpunimit të kufizuar me INTERPOL-in janë kapërcyer me anë të bashkëpunimit më të ngushtë me Europol-in, Agjencinë e Bashkimit Evropian për Zbatimin e Ligjit. Ky bashkëpunim lehtësohet në bazë të një marrëveshjeje pune për bashkëpunimin strategjik, të nënshkruar nga Kosova dhe Europol-i në vitin 2020, për t'i mundësuar Kosovës të ketë qasje në Aplikacionin e Sigurt të Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit (SIENA). Kjo marrëveshje i mundëson Kosovës të dërgojë një zyrtar ndërlidhëse në Europol dhe të shkëmbejë informacione të klasifikuara në mënyrë të sigurt.<sup>12</sup> Ky shkëmbim i drejtpërdrejtë i informacionet është përdorur që prej prillit të vitit 2022.<sup>13</sup>

Megjithatë, nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me agjencinë e bashkëpunimit juridik të BE-së, Eurojust, për shkak të kundërshtimit të pesë shteteve anëtare të BE-së, të cilat nuk e njohin Kosovën si shtet.<sup>14</sup> Niveli dhe forma e bashkëpunimit policor me këto shtete ndryshon nga njëri shtet në tjetrin. Për shembull, shkëmbimi i informacioneve policore me Serbinë kryhet nëpërmjet Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe përfaqësuesit special të BE-së, ndërsa për vendet e tjera, kryhet nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse të UNMIK.<sup>15</sup>

Bashkëpunimi policor me Bosnjën dhe Hercegovinën, Greqinë dhe Sllovinë është i fuqishëm dhe karakterizohet pjesërisht nga ekstradimet e suksesshme. Ka bashkëpunim të mirë edhe me Rumaninë.<sup>16</sup> Ka bashkëpunim të dobët midis Spanjës dhe Kosovës, sidomos në lidhje me arrestimin dhe ekstradimin e personave të shpallur në kërkim.<sup>17</sup> Bashkëpunimi me Serbinë varet nga klima politike. Edhe pse nuk ka pasur kurrë asnjë rast ekstradimi midis Kosovës dhe Serbisë, ndonjëherë ka pasur bashkëpunim të mirë jozyrtar policor

midis dy vendeve, në varësi të rastit. “Një kosovar që kërkohej për grabitje të armatosur u gjet në Serbi”, thotë një zyrtar i Policisë së Kosovës, duke cituar një shembull të tillë pozitiv. “Nëpërmjet bashkëpunimit jozyrtar policor

dhe me mbështetjen e autoriteteve malazeze, i dyshuari u arrestua nga Policia e Serbisë, i dorëzua Policisë së Malit të Zi dhe pastaj Policisë së Kosovës”.<sup>18</sup>

## KRIMINELËT DHE TË ARRATISURIT SHFRYTËZOJNË TENSIONET POLITIKE

Mungesa e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor me Serbinë dhe me Spanjën i ka bërë këto dy vende streha të sigurt për të arratisurit kosovarë, sidomos për ata që kanë të bëjnë me krimin e rëndë dhe të organizuar, siç janë trafikimi i drogës dhe vrasjet.<sup>19</sup> Policia në Kosovë ka informacione të besueshme se disa të arratisur të tillë janë në Spanjë dhe në Serbi, ku bëjnë jetë normale (në mos të fshehtë) me familjet e tyre.<sup>20</sup>

Pavarësisht kërkesave të drejtuara autoriteteve spanjolle nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse së UNMIK-ut me INTERPOL-in, në përgjithësi, nuk janë marrë masa.<sup>21</sup> Megjithatë, kjo situatë duket po fillon të ndryshojë. Në vitin 2022, autoritetet spanjolle iu dërguan autoriteteve kosovare kërkesën e parë për mbledhjen e provave për një rast të trafikimit të drogës.<sup>22</sup>

Milan Radoiçiçi, i dyshuari kryesor për vrasjen në vitin 2018 të politikanit kosovaro-serb, Oliver Ivanoviç, përfitoi nga bashkëpunimi i dobët policor për t'u arratisur në Serbi.<sup>23</sup> Problemi ndikon te të dyja palët. Mendohet se të arratisurit serbë e kanë përdorur Kosovën si strehë të sigurt. Disa qytetarë serbë që kërkohen për vrasje, trafikim droge dhe krim të organizuar dhe që janë arrestuar në Kosovë, janë lënë të lirë për shkak se Serbia nuk ka bërë kërkesë për ekstradim.<sup>24</sup>

Së fundmi, Radoiçiçi, zëvendëskryetari i Listës Serbe, grupi politik më i fuqishëm kosovaro-serb, ishte në radhët e rreth 30 serbëve të armatosur rëndë, të cilët u përfshirë në atë që Parlamenti Evropian<sup>25</sup> e ka quajtur “sulm terrorist” pranë fshatit të Banjskës në veri të Kosovës, më 24 shtator, dhe që është konsideruar si rasti më i rëndë ku autorët e veprës penale i kanë shpëtuar drejtësisë. Radoiçiçi është nën sanksionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shkak se dyshohet se ka qenë i përfshirë në krimin e organizuar. Ai u ndalua në Serbi në datën 3 tetor dhe ka pranuar se grupi i tij ka vrarë një polic kosovar, por një gjykatë e Beogradit e la të lirë një ditë pas ndalimit.<sup>26</sup> Sipas ministrit të Brendshëm të Kosovës, në këtë rast janë përfshirë më shumë se 80 persona<sup>27</sup> dhe është konfiskuar një sasi e madhe armësh të rënda.<sup>28</sup> Presidenti Vuçiç pranoi se Radoiçiçi kishte qenë dikur një aleat i ngushtë i tij dhe tha se nuk mund ta ekstradojë ngaqë Serbia nuk e njeh Kosovën.<sup>29</sup> Radoiçiçi ka dhënë dorëheqjen nga Lista Serbe, por mbetet për t'u parë se si do ta hetojnë rastin autoritetet serbe brenda vendit të tyre dhe se në çfarë mase do të bashkëpunojnë me autoritetet kosovare.

Organizatave kriminale dhe kriminelët shpesh kërkojnë shtete ku zbatimi i ligjit është i dobët ose shtete që kanë probleme politike, me qëllim që të gjejnë strehë aty. Shkalla dhe cilësia e marrëdhënieve diplomatike dhe dypalëshe midis shteteve nuk është mirë të ndërhyjë te bashkëpunimi policor, sidomos kur bëhet fjalë për hetimin e krimit të organizuar, i cili po merr gjithmonë e më shumë përmasa ndërkombëtare. Bashkëpunimi policor, pavarësisht marrëdhënieve politike, është

thelbësor për tejkalimin e pengesave juridiksionale, shpërndarjen e informacioneve, pengimin e krijimit të këtyre strehëve të sigurt dhe shkatërrimin e operacioneve kriminale. Nëse shtetet kanë shqetësime në lidhje me krimin e organizuar në Kosovë ose me kriminelët që vijnë nga Kosova, atëherë është me vend që t'i mundësojnë këtij juridiksioni që ta zbatojë ligjin dhe të veprojnë me shpejtësi me qëllim trajtimin e një problemi që shtrihet përtej kufijve shtetërorë.

## Notes

- 1 Radio Evropa e Lire, Sheremet Ahmeti - Drejtor i policisë së Kosovës, 10 dhjetor 2008, <https://www.evropaelire.org/a/1358320.html>.
- 2 Kërkesa e Tajvanit për anëtarësim është bllokuar gjithashtu, ndërsa Palestina u bë anëtare në vitin 2017.
- 3 Radio Free Europe, *Kosovo fails for third time to win INTERPOL membership*, 20 nëntor 2018, <https://www.rferl.org/a/kosovo-fails-for-third-time-to-win-interpol-membership/29610709.html>.
- 4 INTERPOL, *Memorandum of Understanding*, <https://www.interpol.int/content/download/10980/file/INTERPOL-UNMIK.pdf>.
- 5 Byroja qendrore kombëtare është pika fokale e shtetit anëtar për të gjitha veprimtaritë e INTERPOL-it.
- 6 Intervistë telefonike me një përfaqësues të Policisë së Shtetit Shqiptar, 25 korrik 2023.
- 7 Intervistë me një përfaqësues të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 20 korrik 2023.
- 8 INTERPOL, *About notices*, <https://www.interpol.int/en/How-we-work/Notices/About-Notices>.
- 9 INTERPOL, *Our 19 databases*, <https://www.interpol.int/en/How-we-work/Databases/Our-19-databases>.
- 10 INTERPOL, *SLTD database (travel and identity documents)*, <https://www.interpol.int/en/How-we-work/Databases/SLTD-database-travel-and-identity-documents>.
- 11 Intervistë me një përfaqësues të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 24 maj 2023.
- 12 European Commission, *Kosovo 2022 report*, 12 tetor 2022, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.
- 13 Më për para, informacioni shkëmbej nëpërmjet Zyrës Suedeze Europol-SIENA të menaxhuar nga EULEX-i; Eulex, *Fighting Criminality Together: The Importance of International Police Cooperation*, 17 nëntor 2021, <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,11,2483>.
- 14 European Commission, *Kosovo 2022 report*, 12 tetor 2022, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.
- 15 Intervistë me një përfaqësues të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 20 korrik 2023.
- 16 Intervistë me një zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, 20 korrik 2023.
- 17 Po aty.
- 18 Intervistë me një zyrtar të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 9 gusht 2023.
- 19 Intervistë me një zyrtar të Policisë së Kosovës, Prishtinë, 24 maj 2023.
- 20 Po aty.
- 21 Po aty.
- 22 Intervistë me një zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë, Prishtinë, 20 korrik 2023.
- 23 Saša Đorđević, *Zločin bez kazne: ubistvo Olivera Ivanovića, Peskanic*, 29 dhjetor 2018, <https://pescanik.net/zlocin-bez-kazne-ubistvo-olivera-ivanovica/>; Ardita Zeqiri, *Udhëheqës të Listës Serbe marrin pjesë në shfaqjen e ushtrisë së Serbisë në Batajnica*, Kallxo, 22 prill 2023, <https://kallxo.com/lajm/udheheqes-te-listes-serbe-marrin-pjese-ne-shfaqjen-e-ushtrise-se-serbise-ne-batajnica/>.
- 24 Faith Bailey, Kreshnik Gashi, Jelena Cosic dhe Serbeze Haxhiaj, *Serbia-Kosovo stalemate allows fugitives to stay free*, Belgrade Insight, 31 maj 2018, <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2019/01/belgradeinsightno252.pdf>.
- 25 European Parliament, *Resolution on the recent developments in the Serbia-Kosovo dialogue*, 19 tetor 2023, [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0372\\_EN.html](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0372_EN.html).
- 26 Sasa Dragojlo and Xhorxhina Bami, *Belgrade court rejects detention for Kosovo Serb kingpin Radoicic*, Balkan Insight, 4 tetor 2023, <https://balkaninsight.com/2023/10/04/belgrade-court-rejects-detention-for-kosovo-serb-kingpin-radoicic/>.
- 27 Valona Tela, Sveçla: Do të kërkojmë ekstradimin e Radoicijit dhe jo vetëm, Radio Free Europe, 29 shtator 2023, <https://www.evropaelire.org/a/svecla-ekstradim-millan-radoicic-/32616330.html>.
- 28 Sasa Dragojlo dhe Xhorxhina Bami, *In Kosovo clash, new bullets and freshly repaired mortars from Serbia*, Balkan Insight, 9 tetor 2023, <https://balkaninsight.com/2023/10/09/in-kosovo-clash-new-bullets-and-freshly-repaired-mortars-from-serbia>.
- 29 N1, *Vucic for Sky News: Radoicic was my close ally, I cannot extradite him to Pristina*, 7 tetor 2023, <https://n1info.rs/english/news/vucic-for-sky-news-radoicic-was-my-close-ally-i-cannot-extradite-him-to-pristina/>.

# A është nxjerrë ndonjë mësim në lidhje me menaxhimin e valës së re të emigracionit në vendet e Ballkanit Perëndimor?

Në vitin 2022, numri i refugjatëve dhe emigrantëve në lëvizje përmes vendeve të Ballkanit Perëndimor arriti nivelin më të lartë që prej vitit 2015. Deri tani, në vitin 2023, kjo rrugë ka mbetur rruga e dytë më aktive që të shpie në Evropë. Kjo situatë po shkakton shqetësime në Ballkanin Perëndimor, por edhe në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Mbretërinë e Bashkuar, ku ekziston frika e rishfaqjes së sfidave me të cilat janë përballur disa shtete në vitet 2015 dhe 2016 në kuadër të përballjes së tyre me miliona njerëz në lëvizje. Që prej asaj kohe, disa shtete kanë ngritur barriera fizike, kanë kërkuar të përmirësojnë marrëdhëniet me shtetet e treta dhe janë përpjekur të përmirësojnë bashkëpunimin shumëpalësh, sidomos nëpërmjet BE-së. Siç është vënë re edhe në rastin e ishullit italian të Lampeduzës, ky sistem tani është nën stres.

Sipas të dhënave paraprake nga Fontex-i (shqipto: fronteks), Agjencia Kufitare e BE-së, në vitin 2022 në bllok kanë hyrë 330 000 emigrantë të parregullt, çka përbën edhe prurjen më të madhe të parregullt që prej vitit 2016.<sup>1</sup> Nga këta, 145 600 emigrantë (45%) kanë ardhur nëpërmjet rrugës së Ballkanit Perëndimor. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, numri i emigrantëve të parregullt është rritur me 136% krahasuar me vitin 2021.<sup>2</sup> Shumica e personave në lëvizje kanë ardhur ose nga rajoni i Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut (MENA) ose përmes këtij rajoni.

Midis janarit dhe gushtit të vitit 2023, rajoni i Ballkanit Perëndimor vazhdoi të ishte rruga e dytë më aktive, edhe pse pati një rënie prej 19% krahasuar me të njëjtën



**Emigrantët shihen në vagonë treni të braktisur pranë Selanikut, Greqi, në rrugën e tyre për të ndjekur rutën e Ballkanit Perëndimor drejt Maqedonisë së Veriut, tetor 2022.**

*Foto: Nicolas Economou/NurPhoto përmes Getty Images*



periudhë të vitit të kaluar, pjesërisht për shkak se Serbia i dha fund ardhjes pa viza të shtetasve të Burundit, Tunizisë, Indisë dhe Guine-Bisaut.<sup>3</sup> Ky ndryshim politik nga ana e Serbisë ndodhi pas ushtrimit të presionit nga BE-ja, e cila ngriti shqetësimin se sistemi po shfrytëzohej nga emigrantët që po e përdornin vendin si trampolinë për t'u hedhur në bllok.

Tri kombësitë kryesore që udhëtojnë përmes rrugës së Ballkanit Perëndimor janë ato siriane, afganistanase dhe turke.<sup>4</sup> Pritet që numrat të vazhdojnë të jenë të lartë si pasojë e shpërthimit të konfliktit midis Izraelit dhe Hamasit, represionit të vazhduar në Afganistan, luftës dhe paqëndrueshmërisë në Libi dhe në Sudan dhe nga vështirësitë ekonomike në shumë vende afrikane. Në gusht, Frontex-i kishte parashikuar një rënie të moderuar për gjithë vitin 2023,<sup>5</sup> por kjo ishte përpara sulmit të Hamasit kundër Izraelit, i cili tani ka nisur pushtimin nga toka të Gazës, një zonë bregdetare e banuar nga palestinezët. Ekzistojnë edhe rreziqet e pasojave të konsiderueshme që shkojnë përtej këtij teatri të konfliktit të drejtpërdrejtë.

Në të njëjtën kohë, agresioni i Rusisë kundër Ukrainës ka shkaktuar krizën më të madhe të refugjatëve në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore. Ndonëse pjesa më e madhe e refugjatëve kanë shkuar drejt vendeve fqinje dhe Evropës Perëndimore, ka dhjetëra-mijëra ukrainas dhe rusë që kanë gjetur strehim në Ballkanin Perëndimor. Ndryshe nga emigrantët që vijnë nga rajoni i MENA-s, të cilët mbështeten kryesisht në rrjetet e kontrabandimit të njerëzve për të aranzhuar kalimin e paligjshëm të kufijve shtetërorë, refugjatët ukrainas në vendet e Ballkanit, në përgjithësi, gjatë vitit 2022 kanë hyrë në këto vende në mënyrë të ligjshme.

Ndonëse lufta në Ukrainë nuk ka të bëjë shumë me rritjen e konsiderueshme të emigracionit të parregullt, ekziston një lidhje e tërthortë për sa i takon zbatimin të ligjit. Pjesa dërrmuese e burimeve humanitare, për shembull, në Hungari, Bullgari dhe Rumani, u përqendruan në pjesën më të madhe të trajtimit i daljes së refugjatëve nga Ukraina në fillim të vitit 2022. Kjo situatë ua bëri më të lehtë emigrantëve që ta kalonin kufirin në mënyrë të paligjshme në vendet që ishin më pak të ruajtura, për shkak të zhvendosjes të personelit ligjzbatues. Po sjellim këtu si shembull kufirin midis Rumanisë dhe Hungarisë, kufirin midis Serbisë dhe Hungarisë dhe kufirin midis Bullgarisë dhe Turqisë.<sup>6</sup> Më tej, lufta ka krijuar një grup ukrainasish të cenueshëm, të cilët po rekrutohen nga rrjetet kriminale për të kryer

detyra të nivelit të ulët, p.sh. të ngasin automjete të ngarkuara me emigrantë.<sup>7</sup> Ka edhe pretendime se rrjetet kriminale ukrainase janë marrë edhe me kontrabandimin e burrave që janë të obliguar t'u bashkohen forcave të armatosura dhe që nuk lejohet të ikin nga Ukraina, për shkak të kufizimit të lëvizjeve.<sup>8</sup>

### **Faktorë kriminalë më të ndryshëm dhe më të dhunshëm**

Në krahasim me shtatë vjet më parë, për sa i takon kontrabandimit të emigrantëve nëpërmjet Ballkanit Perëndimor, vihet re se ka prirje të reja. Rrjetet duket se kanë përmirësuar aftësinë për t'u përshtatur dhe janë bërë më të decentralizuara. Përdorimi i teknologjisë, sidomos grupet me biseda të koduara (enkriptuara), aplikacionet e internetit në telefon dhe sistemet e GPS-së, e kanë demokratizuar tregun dhe e kanë pakësuar nevojën për centralizimin dhe mirëkoordinimin e veprimeve.<sup>9</sup> Teknologjia ka pakësuar edhe nevojën për udhërrëfyes. Tani rekrutimi dhe reklamimi i kontrabandimit të emigrantëve është më i lehtë.<sup>10</sup> Për të paguar për shërbimet e kontrabandimit, tani përdoren edhe aplikacionet e transfertave të parave nga interneti.<sup>11</sup> Më tej, përdorimi i enkriptimit ia ka bërë më të vështirë policisë që të bjerë në gjurmët e rrjeteve të kontrabandimit dhe t'i hetojë ato, ndryshe nga sa ndodhte në vitin 2015 dhe 2016, ku këto grupe pikaseshin duke u mbështetur në informacionet e telefonave celularë.<sup>12</sup>

Emigrantët zakonisht shkojnë nga njëri vend në tjetrin, duke paguar për secilin segment udhëtimi dhe jo për gjithë udhëtimin siç ndodhte kryesisht midis viteve 2015 dhe 2017. Për të lehtësuar kalimin e paligjshëm të kufijve, kontrabandistët zakonisht mbështeten te kontaktet e tyre të besuara, shpesh bashkatdhetarë, në shtetet fqinje.<sup>13</sup> Vazhdon të mbetet i njëjtë fakti se korrupsioni mund të ndihmojë me hapjen e dyerve ose t'i bëjë rojat kufitarë të bëjnë një sy qorr dhe një vesh shurdh.<sup>14</sup>

Duket se ka ndryshuar edhe profili i kontrabandistëve. Ndërkohë që në vitet 2015 dhe 2016, shumica e kontrabandistëve ishin shtetas të vendit ku vepronin, tregu duket se është bërë më i paqëndrueshëm dhe ndërkombëtar. Nuk ndodh rrallë që qytetarët e një shteti të Evropës Juglindore të përfshihen, për shembull, si shoferë, për të kontrabanduar emigrantë drejt një shteti tjetër të rajonit. Shoferët shpesh rekrutohen nëpërmjet rrjeteve sociale në internet.<sup>15</sup> Gjatë dy-tre viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të shoferëve në Bullgari, të cilët kanë ardhur nga Ukraina,

Gjeorgjia dhe Moldavia.<sup>16</sup> Edhe emigrantët ose ish-emigrantët, sidomos ata nga Afganistani dhe Pakistani, Afrika e Veriut ose rajonet ku banojnë kurdët, marrin pjesë aktivisht në kontrabandim, ndër të tjera, si rekrutues në qendrat azilkërkuese, si transportues, si qiradhënës për strehimin e emigrantëve dhe si organizatorë të logjistikës. Ata janë të pranishëm sidomos në qendrat kryesore ku emigrantët kërkojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme.<sup>17</sup> Shumë shpesh, në shumë shtete të rajonit, ndjekja e automjeteve ose ngarja e pakujdesshme e automjeteve bëhen shkak për aksidentet rrugore, ku humbin jetën emigrantët, shoferi dhe/ose përdoruesit e tjerë të rrugës.<sup>18</sup>

Meqenëse kostoja dhe niveli i sofistikimit që nevojiten për të hyrë në tregun e kontrabandimit, me sa duket, janë mjaft të ulëta, por përfitimet mund të jenë të majme, duket se ka konkurrencë të madhe në lidhje me qendrat kyçe. Kjo konkurrencë shpeshherë është e dhunshme. Vitin e kaluar, kanë ndodhur shumë incidente të dhunshme në kufirin midis Serbisë dhe Hungarisë, ku ka pasur edhe të shtëna me armë zjarri.<sup>19</sup> Në disa raste, dhuna ushtrohet kundër policisë dhe rojave të kufirit. Raportohet se në vitin 2022, në Hungari, u plagosën 12 oficerë policie dhe 29 oficerë të gardës kombëtare,<sup>20</sup> ndërsa në Bullgari në vitin 2022 u vranë katër oficerë policie dhe u plagosën shumë të tjerë gjatë përplasjeve të dhunshme me kontrabanduesit e emigrantëve.<sup>21</sup> Në raste të tjera, ka përplasje të dhunshme midis grupeve kontrabanduese kundërshtarë. Për shembull, të tilla incidente janë raportuar në Serbi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku ka pasur përplasje midis grupit të kurdëve dhe grupit të afrikano-veriorëve (marokenë dhe algerianë).<sup>22</sup> Ndonjëherë, dhunë ushtrojnë edhe kontrabanduesit mbi emigrantët, për shembull, kur këta të fundit përpiqen të kapërcejnë ndonjë gardh (si gardhi që ndan Serbinë me Hungarinë) pa paguar për shërbimin. Rastet më të shumta të dhunës ndodhin kryesisht te pikat kryesore të daljes, si në Serbi dhe pranë kampeve informale të emigrantëve.<sup>23</sup>

### **Këtë problem ndërkufitar mund ta zgjidhin vetëm reagimet shumëpalëshe**

Që prej valës masive të refugjatëve dhe emigrantëve në vitin 2015, vendet e Evropës Juglindore janë prirë drejt ngritjes së mureve dhe gardheve mbrojtëse.

Nga ana e saj, BE-ja është munduar të përforcojë perimetrin e jashtëm, sidomos nëpërmjet përdorimit të Frontex-it. Në këtë kuadër, janë nënshkruar marrëveshje të reja me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin

e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, për bashkëpunimin operativ në fushën e menaxhimit të kufijve. Këto marrëveshje mundësojnë, ndër të tjera, edhe veprimin në këto vende të oficerëve të Korpusit të Përhershëm të Frontex-it.<sup>24</sup> Më tej, në vend që thjesht “ta mbyllin rrugën e Ballkanit” dhe t’i lënë këto vende të mbrojnë vet veten e tyre – siç ndodhi gjatë vitit 2016 – tani ekziston një ndjenjë më e madhe solidariteti, në mos interesi vetjak, për vendet e BE-së që të punojnë më ngushtë me fqinjët e tyre në Ballkanin Perëndimor, në drejtim të menaxhimit dhe pakësimit të fluksit të refugjatëve dhe emigrantëve.

Duke u mbështetur në “Paktin e ri për emigracionin dhe azilin”, i cili u propozuar në shtator të vitit 2020, Bashkimi Evropian miratoi, në dhjetor të vitit 2022, një plan veprimi për emigracionin në Ballkanin Perëndimor. Ky plan ka 20 masa operative, të kategorizuara në pesë fusha kryesore: forcimi i menaxhimit të kufijve përgjatë rrugëve të trafikut; procedurat e shpejta të kërkimit të azilit dhe krijimi i kapaciteteve të pritjes; lufta kundër kontrabandimit të emigrantëve; përmirësimi i bashkëpunimit për ripanimin dhe për kthimet; dhe harmonizimi i politikës së vizave.<sup>25</sup> Miratimi i këtyre masave, jo vetëm që pritet të ndihmojë BE-në dhe gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që ta trajtojnë emigracionin në mënyrë më efektive, por mund të çojë në përsheptimin e procesit të anëtarësimit në BE në fushën e migrimit dhe menaxhimit të kufirit.

Sfidë këtu do të jetë gjetja e përfitimeve të përbashkëta, për shembull, nëpërmjet bashkëndarjes më efektive të informacioneve, në vend të lojërave “kush e ka fajin” (siç ndodhi midis Austrisë dhe Rumanisë, ose në lidhje me vendimin polemizues të Hungarisë për të liruar nga burgu mbi 700 kontrabandistë të njerëzve të huaj, në qershor të vitit 2023), ose nëpërmjet ushtrimit të presionit mbi vendet e Evropës Juglindore, me qëllim që këto të kryejnë kthimin e emigrantëve pa infrastrukturën e nevojshme. Ndër masat praktike mund të përfshihen: operacionet e përbashkëta, standardizimi i metodologjisë për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve rreth emigracionit të parregullt dhe përmirësimi i procedurave për identifikimin dhe regjistrimin e emigrantëve në kufij. Po ashtu, do të ishte vendim i mirë që vendet e Ballkanit Perëndimor të bëheshin pjesë e Eurodac-it (sistemi evropian për krahasimin e gjurmëve të gishtave të azilkërkuësve).

Në fund, faktorët nxitës që i bëjnë kaq shumë emigrantë të dëshpëruar të vënë jetën e tyre në rrezik duke kërkuar mbrojtje dhe mundësi më të mira për të ardhmen, duhen

trajtuar në nivel ndërkombëtar, dhe jo thjesht në nivelin evropian. Vendet në BE, Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë, Mbretëria e Bashkuar dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të kërkojnë bashkërisht një reagim global më të koordinuar ndaj flukseve të mëdha të njerëzve në lëvizje, duke përfshirë edhe nëpërmjet zbatimit të Kompaktit Global për Emigracion të Sigurt, të

Organizuar dhe të Rregullt. Përndryshe, do të vazhdojnë presionet jopërpjesëtimore mbi vende të caktuara si në Greqi dhe Itali, mungesa e solidaritetit dhe bashkëpunimit, dhe rritja e populizmit të shkaktuar, pjesërisht, nga zhgënjimi i popullsisë me paaftësinë e qeverive për të trajtuar emigracionin.

## Notes

- 1 Frontex, *EU's external borders in 2022: Number of irregular border crossings highest since 2016*, 13 janar 2023, <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/eu-s-external-borders-in-2022-number-of-irregular-border-crossings-highest-since-2016-YsAZ29>.
- 2 Po aty.
- 3 Frontex, *Central Mediterranean accounts for half of irregular border crossings in 2023*, 14 shtator 2023, <https://www.frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/central-mediterranean-accounts-for-half-of-irregular-border-crossings-in-2023-G6q5pF>; Sasa Dragojlo, *Serbia ends visa-free regimes with Tunisia and Burundi*, 25 tetor 2022, <https://balkaninsight.com/2022/10/25/serbia-ends-visa-free-regimes-with-tunisia-and-burundi/>.
- 4 Frontex, *Central Mediterranean accounts for half of irregular border crossings in 2023*, 14 shtator 2023, <https://www.frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/central-mediterranean-accounts-for-half-of-irregular-border-crossings-in-2023-G6q5pF>.
- 5 Frontex, *Risk Analysis for 2023/2024*, Gusht 2023, [https://www.frontex.europa.eu/assets/Publications/General/ARA\\_2023.pdf](https://www.frontex.europa.eu/assets/Publications/General/ARA_2023.pdf).
- 6 Tihomir Bezlov, Atanas Rusev dhe Dardan Kocani, *Borderline: Impact of Ukraine war on migrant smuggling in South Eastern Europe*, Global Initiative Against Transnational Organized Crime (GI-TOC), shtator 2023, <https://globalinitiative.net/analysis/ukraine-war-impact-migrant-smuggling-south-eastern-europe/>.
- 7 Po aty.
- 8 GI-TOC, *New front lines: Organized criminal economies in Ukraine in 2022*, shkurt 2023, <https://globalinitiative.net/analysis/organized-criminal-economies-ukraine-2022>.
- 9 Europol, *Criminal networks in migrant smuggling*, qershor 2023, <https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Europol%20Spotlight%20Report%20-%20Criminal%20networks%20in%20migrant%20smuggling.pdf>.
- 10 Europol, *Criminal networks in migrant smuggling*, qershor 2023, <https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Europol%20Spotlight%20Report%20-%20Criminal%20networks%20in%20migrant%20smuggling.pdf>.
- 11 Po aty; Tihomir Bezlov, Atanas Rusev dhe Dardan Kocani, *Borderline: Impact of Ukraine war on migrant smuggling in South Eastern Europe*, GI-TOC, shtator 2023, <https://globalinitiative.net/analysis/ukraine-war-impact-migrant-smuggling-south-eastern-europe/>.
- 12 Po aty.
- 13 Po aty.
- 14 Europol, *Criminal networks in migrant smuggling*, qershor 2023, <https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Europol%20Spotlight%20Report%20-%20Criminal%20networks%20in%20migrant%20smuggling.pdf>;
- 15 Tihomir Bezlov, Atanas Rusev dhe Dardan Kocani, *Borderline: Impact of Ukraine war on migrant smuggling in South Eastern Europe*, GI-TOC, shtator 2023, <https://globalinitiative.net/analysis/ukraine-war-impact-migrant-smuggling-south-eastern-europe/>.
- 16 Po aty.
- 17 Europol, *Criminal networks in migrant smuggling*, qershor 2023, <https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Europol%20Spotlight%20Report%20-%20Criminal%20networks%20in%20migrant%20smuggling.pdf>;
- 18 Po aty.
- 19 MTI-Hungary Today, *Armed incidents involving migrants on the rise at Hungarian border*, 11 nëntor 2022, <https://hungarytoday.hu/armed-incidents-involving-migrants-on-the-rise-at-hungarian-border/>; AP News, *Serb police: Man shot in border town clash between migrants*, 25 nëntor 2022, <https://apnews.com/article/europe-shootings-hungary-migration-western-269fab3f41a42df0d053e8ed865b49dc>.
- 20 Schengen News, *Hungarian border police detected nearly 270,000 illegal migrants last year*, 6 janar 2023, <https://www.schengenvisainfo.com/news/hungarian-border-police-detected-nearly-270000-illegal-migrants-last-year>.
- 21 Dunavmost, *Four police officers have died in the last 12 months due to migrant pressure*, 17 shkurt 2023, <https://www.dunavmost.com/novini/chetirima-politsai-zaginaha-za-poslednite-12-mesetsa-zaradi-migrantskiya-natisk>.
- 22 GI-TOC, *Increasing migratory pressures in Serbia have led to conflict between people smuggling groups and crackdowns on migration*, gusht 2023, <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-016/01-increasing-migratory-pressures-in-serbia-have-led-to-conflict.html>; Intervistë me një oficer të policisë kufitare të Kosovës, Prishtinë, 8 nëntor 2023.
- 23 GI-TOC, *Increasing migratory pressures in Serbia have led to conflict between people smuggling groups and crackdowns on migration*, gusht 2023, <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-016/01-increasing-migratory-pressures-in-serbia-have-led-to-conflict.html>.
- 24 European Commission, *EU Action Plan on the Western Balkans*, 5 dhjetor 2022, [https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2022-12/Western%20Balkans\\_en.pdf](https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2022-12/Western%20Balkans_en.pdf).
- 25 Po aty.

# Rreziqet në burgje mund të ndikojnë për keq te lufta kundër krimit në Ballkanin Perëndimor.


Ballkanit Perëndimor i ka dalë emri për krimin e organizuar. Në krahasim me vendet e tjera në Evropë, ky rajon ka raporte relativisht të larta të burgosjes. Në teori, burgjet duhet të jenë vende korrektuese dhe pengesa e fundit e rrugës së krimit. Në realitet, burgjet janë shpesh shkolla ku rekrutohen autorët e veprave të vogla penale për t'u marrë me krim të rëndë të

organizuar, për t'u bërë nyja të rrjeteve dhe madje mbështetës për kryerjen e veprave penale. Po të mos reformohen, burgjet në Ballkanin Perëndimor rrezikojnë ta përkeqësojnë, dhe jo ta korrigojnë, problemin e krimit të organizuar në rajon.

Kriminaliteti	2023		2021	
	Evropa	Bota	Evropa	Bota
Serbia	3	40	2	33
Mali i Zi	5	54	4	45
Bosnja dhe Hercegovina	8	57	5	49
Shqipëria	15	87	9	61
Maqedonia e Veriut	18	93	11	74

**FIGURA 1** Renditja e vendeve të Ballkanit Perëndimor në krahasim me 44 shtetet evropiane dhe me 193 vendet e botës (1 = vendi më i keq).

Burimi: Indeksi Global i Krimit të Organizuar, <https://ocindex.net/>



**FIGURA 2** Raporti i të burgosurve me popullsinë (të burgosur për 100 000 banorë) në vitin 2022.

Burimet: Statistikat Kriminale Vjetore të Këshillit të Evropës,<sup>3</sup> World Prison Brief Data,<sup>4</sup> të dhëna të marra nga institucionet në bazë të kërkesës<sup>5</sup> dhe "Večernji List".<sup>6</sup>

Sipas "Indeksit Global të Krimit të Organizuar", të botuar në shtator të vitit 2023, tri nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë ndër dhjetë vendet më të këqija në Evropë për kriminalitetin (shihni figurën 1).<sup>1</sup> Nuk është habi që Komisioni Evropian ka theksuar nevojën që vendet e rajonit të shfaqin përparime të konsiderueshme në drejtim të luftës kundër krimit.<sup>2</sup> Po ashtu, ndoshta nuk është habi që katër nga gjashtë vendet e rajonit kanë norma burgosjeje që janë mbi medianën e Evropës (shih figurën 2).

Për shembull, në vitin 2022, në burgjet e Serbisë kishte 10 557 të burgosur, ndërsa në burgjet e Shqipërisë 5 357.<sup>7</sup> Në këto dy vende, më shumë se një çerek e të gjithë të burgosurve po vuajnë dënimin për vepra penale të ndërlidhura me drogën.<sup>8</sup> Megjithatë, jo të gjithë vuajnë dënime për shkak të prodhimit dhe shpërndarjes së drogës. Shumica janë në burg për posedim të drogës dhe jo për veprimtari të krimit të organizuar. Në të vërtetë, nga rreth 23 000 të burgosur në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2022,<sup>9</sup> vetëm disa qindra janë dënuar për vepra penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar: 75 në Shqipëri,<sup>10</sup> 134 në Bosnjë dhe Hercegovinë,<sup>11</sup> 11 në Kosovë,<sup>12</sup> 48 në Maqedoninë e Veriut,<sup>13</sup> 17 në Mal të Zi<sup>14</sup> dhe 144 në Serbi.<sup>15</sup>

Ndonëse këta numra janë relativisht të vegjël, burgjet në rajon bartin rreziqet e vetvetishme që mund ta nxisë krimin e organizuar në vend që ta pakësojë atë.

### **Komunikimi i paligjshëm nga burgjet**

Në disa raste, burgjet nuk duket se përbëjnë pengesë për menaxhimin e veprimtarive kriminale. Midis periudhës 2014-2021, Darko Shariqi (Darko Šarić), lord i dënuar i drogës, banoi në qelinë 117 në Qendrën e Ndalimit të Gjykatës Speciale në Beograd të Serbisë.<sup>16</sup> Prokurorët zbuluan se Shariqi kishte pasur komunikim të vazhdueshëm, kishte dhënë urdhra, duke përfshirë edhe urdhra për vrasje, dhe kishte menaxhuar financat duke përdorur pajisjet e enkriptuara "Sky ECC", gjatë periudhës tetor 2020-dhjetor 2021.<sup>17</sup> Shariqi i kryente këto veprime nga një ndërtesë që gjoja ka siguri të lartë dhe ku ndalohej rreptësisht përdorimi i telefonit.<sup>18</sup>

Serbia nuk është i vetmi vend në rajon që po përballet me vështirësitë e komunikimeve të paligjshme nga brenda burgjeve. Në shtator të vitit 2023, një burgun e Spuzhit, në Mal të Zi, u gjet një grumbull telefonash dhe karikuesish të fshehur.<sup>19</sup> Në korrik të vitit 2023, brenda një kondicioneri u gjetën gjashtë celularë të fshehur.<sup>20</sup> Në janar të vitit 2023, u zbulua një dron, që



**Një dron i pajisur me dy telefona celularë u zbulua në burgun në Spuzh, Mali i Zi.**

*Fotot: Administrata për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Mal të Zi*

transportonte dy telefona celularë, ndërkohë që po fluturonte mbi burg.<sup>21</sup> Në nëntor të vitit 2022, u gjet një tenxhere ku ishin fshehur shumë telefona dhe një shënim ku shkruhej "Vëllai të do shumë".<sup>22</sup>

### **Rekrutimi: nga burgjet te krimi i organizuar**

Burgjet në shumë shtete anembanë botës janë mjedise të përshtatshme për rekrutimin e autorëve të veprave të lehta penale për t'i bërë ata pjesë të bandave ose grupeve kriminale. Të burgosurit që vuajnë dënime për vepra të lehta penale, si posedimi i drogës, përzihen me kriminelët me përvojë. Për shembull, në Serbi, të burgosurit më të vjetër, me historik kriminal dhe me lidhje me grupet huligane të futbollit, zënë miqësi me të burgosurit e rinj në moshë, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë më përpara në krimin e organizuar, dhe u mësojnë atyre marifetet e zanatit. Pasi lirohen nga burgu, këta individë të rinj shpesh bëhen pjesë e grupeve kriminale. Kur del nga burgu edhe mësuesi, këta ndonjëherë i futen biznesit së bashku, ku zakonisht merren me trafikimin e drogës.<sup>23</sup>

Për pothuaj një dekadë, Mali i Zi është torturuar nga përplasjet vdekjeprurëse midis dy grupeve të dhunshme kriminale që konkurrojnë për kontrollin e tregut të kokainës. Institucionet korrektuese në Mal të Zi, si burgu në Spuzh ku vuajnë dënimin drejtuesit dhe anëtarët e nivelit të lartë të grupeve të krimit të organizuar, janë qendra kryesore për rekrutimin e anëtarëve të rinj.<sup>24</sup> Për t'i rekrutuar, të dënuarit me përvojë u ofrojnë anëtarëve të rinj mbrojtje, avokatë të shtrenjtë, forma të tjera të mbështetjes financiare dhe shumë stimuj të tjerë.<sup>25</sup>

Një problem i ndërlidhur me këtë është edhe mbështetja e pamjaftueshme e të burgosurve pas vuajtjes së dënimit. Kur të burgosurit dalin nga burgu, shpesh ata nuk kanë rrjete të ligjshme të mbështetjes, mundësi punësimi, madje as dokumentet bazë. Jo vetëm kaq, por ata damkosen edhe brenda komuniteteve të tyre. Për pasojë, disa kërkojnë të gjejnë mbështetje të rrjetet e krimit të organizuar, me anëtarët e të cilave janë shoqëruar gjatë kohës që ishin në burg. Mungesa e rehabilitimit rrit rreziqet e recidivizmit.

### **Korrupsioni nga brenda**

Siguria në burgje shpesh cenohet nga korrupsioni. Ballkani Perëndimor nuk përbën përjashtim. Siç shpjegoi drejtori i një burgu në Maqedoninë e Veriut, korrupsioni në radhët e oficerëve të institucioneve korrektuese ka bërë të mundur futjen kontrabandë dhe të paligjshme në burgje të armëve, telefonave dhe drogës.<sup>26</sup> Sipas një ish-drejtori të njërit prej burgjeve të Maqedonisë së Veriut, ky vend është i pari në Evropë për nga numri i arratisjeve nga burgu. "Kjo tregon se sa i përhapur është kriminaliteti në sistemin e burgjeve".<sup>27</sup>

Kjo është theksuar në raporte të tjera.<sup>28</sup> Në Mal të Zi, janë përhapur pretendimet për ekzistencën e bashkëpunimit midis personelit të burgut dhe grupeve të krimit të organizuar.<sup>29</sup> Në Shqipëri, ndodhi një rast i tillë në prill të vitit 2022, ku ushtruesi i detyrës së drejtorit të burgut të Shkodrës u arrestua me pretendimin se kishte shpërdoruar detyrën.<sup>30</sup> Paraardhësi i tij ishte pezulluar më herët për vetëm tre muaj për shkak se pretendohet se kishte falsifikuar dokumente.<sup>31</sup> Nevoja për t'i trajtuar këto rreziqe është edhe më e ngutshme, sidomos kur marrim parasysh riatdhësimin në rajon të të burgosurve që vuajnë dënimin jashtë rajonit.

## TRANSFERIMET E TË BURGOSURVE DREJT SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Ndonëse disa vende të Ballkanit Perëndimor kanë relativisht shumë të burgosur, një numër i konsiderueshëm i shtetasve të këtij rajoni vuajnë dënimin në burgje të huaja. Për shembull, në burgjet e Mbretërisë së Bashkuar ka 1 475 shtetas shqiptarë, që përbëjnë 14% të të gjithë të burgosurve të huaj në këtë shtet.<sup>32</sup>

Në maj të vitit 2023, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar arritën një marrëveshje për transferimin e të burgosurve. Marrëveshja mbështetet në një dokument<sup>33</sup> që hyri në fuqi në maj të vitit 2022.<sup>34</sup> Sipas kësaj marrëveshjeje, Mbretëria e Bashkuar do ta mbështesë Shqipërinë me modernizimin e infrastrukturës së burgjeve. Në këmbim, Shqipëria ka premtuar se do të riatdhesojë deri në 200 shtetas shqiptarë, të cilët, aktualisht, po vuajnë katër ose më shumë vjet heqje lirie në burgjet e Mbretërisë së Bashkuar.<sup>35</sup> Zyrtarët e Mbretërisë së Bashkuar kanë theksuar se kjo nismë nuk do të çojë vetëm në uljen e kostove që përballohen nga taksapaguesit britanikë, por do të zgjidhë deri diku edhe problemin e mbipopullimit të burgjeve në Mbretërinë e Bashkuar.<sup>36</sup> Megjithatë, ka pasur kritika në Shqipëri se marrëveshja është karakterizuar nga "debati i paktë politik dhe publik lidhur me specifikat dhe nga përfshirja e paktë e shoqërisë civile".<sup>37</sup>

Ministri i Drejtësisë i Shqipërisë, Ulsi Manja, thotë se marrëveshja promovon riintegrimin e të dënuarve pa përdorur paratë e taksapaguesve kombëtarë dhe kontribuon në përmirësimin e sistemit të burgjeve në Shqipëri. Nga ana tjetër, disa gjyqtarë dhe avokatë kanë ngritur shqetësime në lidhje me ndikimin e pritjes së 200 të burgosurve të tjerë në sistemin e mbipopulluar të burgjeve shqiptare.<sup>38</sup>

Ndërkohë, një vend i Ballkanit Perëndimor ka rënë dakord të strehojë të burgosurit e një shteti të BE-së. Në dhjetor të vitit 2021, Kosova pranoi të akomodonte 300 të burgosur danezë, ku Danimarka do të paguante një tarifë vjetore prej 15 milionë eurosh për të marrë me qira ambientet e burgut të Gjilanit.<sup>39</sup> Sipas ministrit të Drejtësisë të Kosovës, falë kësaj marrëveshjeje, vendi do të fitojë 210 milionë euro, pjesa më e madhe e të cilave do të përdoren për nismat në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe për trajnimin e personelit të burgut.<sup>40</sup> Disa ekspertë në Kosovë ishin kundër marrëveshjes,<sup>41</sup> por në qershor të vitit 2023, qeveria dorëzoi një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.<sup>42</sup>

Edhe pse disa vende të Ballkanit Perëndimor i kanë përmirësuar sistemet e tyre korrektuese, siç pranon edhe Komisioni Evropian në progres raportet e tij të vitit 2022, ende ka disa sfida sistemike. Mbipopullimi i burgjeve është problem që haset kudo në rajon, me përjashtim të Kosovës. Për sa i takon Maqedonisë së Veriut, Komisioni Evropian shprehet se "duhen zbatuar sa më shpejt zgjidhjet sistemike për të përmirësuar kushtet në burgje", ndërsa për sa i takon Shqipërisë, Komisioni shprehet se kushtet në burgje "vazhdojnë të mbeten shqetësim".<sup>43</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë, "nuk ka pasur përpjekje për të përmirësuar kushtet në burgje", çka nënkupton se, për fat të keq, nuk ka pasur përparim.<sup>44</sup> Nga ana tjetër, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia kanë bërë hapa përpara, në drejtim të miratimit të standardeve ndërkombëtare.<sup>45</sup>

Për ta përforcuar sigurinë në burgje, është e domosdoshme të përdoret fjala e fundit e teknologjisë dhe të bëhen kontrole periodike në qeli. Në të njëjtën kohë, është tepër e rëndësishme të përmirësohet infrastruktura gjyqësore dhe e institucioneve korrektuese, për të siguruar që ambientet të përmbushin standardet moderne. Është vendimtare të ndiqet një qasje gjithëpërfshirëse për përmirësimin e mjedisit korrektues, duke u përqendruar kryesisht te përmirësimi i kushteve në të cilat punon personeli, duke e mbrojtur atë nga presionet e panevojshme politike dhe kriminale dhe duke kultivuar kulturën e llogaridhënies në vend të dembelizmit të mundshëm. Krahas kësaj, zbatimi në burgje i programeve të rehabilitimit, nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, premtim pakësimin e recidivizmit.

## Notes

- 1 Global Initiative Against Transnational Organized Crime (GI-TOC), *Global Organized Crime Index 2023: A fractured world*, shtator 2023, <https://ocindex.net/report/2023/04-continental-overview.html#europe>.
- 2 European Commission, *2022 Communication on EU Enlargement Policy*, 12 tetor 2022, 8-9, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/2022%20Communication%20on%20EU%20Enlargement%20Policy-v3.pdf>.
- 3 Marcelo F. Aebi, Edoardo Cocco dhe Lorena Molnar, *SPACE: Council of Europe Annual Penal Statistics*, 15 dhjetor 2022, përditësuar më 26 qershor 2023, [https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626\\_SPACE-I\\_2022\\_FinalReport.pdf](https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626_SPACE-I_2022_FinalReport.pdf); Marcelo F. Aebi, Edoardo Cocco dhe Lorena Molnar, *Prisons and Prisoners in Europe 2022: Key Findings of the SPACE I survey*, Council of Europe and University of Lausanne, përditësuar më 26.06.2023, [https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626\\_Key-Findings-SPACE-I\\_Prisoners-and-Prisoners-in-Europe-2022.pdf](https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626_Key-Findings-SPACE-I_Prisoners-and-Prisoners-in-Europe-2022.pdf).
- 4 Shihni <https://www.prisonstudies.org/world-prison-brief-data>.
- 5 Të dhëna të marra nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bazë të kërkesës së GI-TOC-së, në gusht të vitit 2023.
- 6 Ljiljana Vidačak, *Evropski zatvori prebukirani, BiH 16. na listi s popunjenošću kapaciteta od 98 posto, Večernji list*, 13 qershor 2023, <https://www.vecernji.ba/vijesti/evropski-zatvori-prebukirani-bih-16-na-listi-s-popunjenošću-kapaciteta-od-98-posto-1687438>.
- 7 Marcelo F. Aebi, Edoardo Cocco dhe Lorena Molnar, *Prisons and Prisoners in Europe 2022: Key Findings of the SPACE I survey*, Council of Europe and University of Lausanne, përditësuar më 26.06.2023, [https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626\\_Key-Findings-SPACE-I\\_Prisoners-and-Prisoners-in-Europe-2022.pdf](https://wp.unil.ch/space/files/2023/06/230626_Key-Findings-SPACE-I_Prisoners-and-Prisoners-in-Europe-2022.pdf).
- 8 Hamdi Firat Buyuk, *Council of Europe: Turkey's Prison Population Rises Beyond 300,000*, Balkan Insight, 27 qershor 2023, <https://balkaninsight.com/2023/06/27/council-of-europe-turkeys-prison-population-rises-beyond-300000/>.
- 9 Të dhënat që paraqiten këtu përfaqësojnë llogaritjet e autorit, mbështetur në burime të ndryshme, duke përfshirë Statistikat Kriminale Vjetore të Këshillit të Evropës, "World Prison Brief Data", raportet zyrtare të shpenzimeve buxhetore dhe të dhënat e marra nga institucionet sipas kërkesës.
- 10 European Commission, *Albania 2022 Report*, 12 tetor 2022, 40, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>.
- 11 European Commission, *Bosnia and Herzegovina 2022 Report*, 12 tetor 2022, 39, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Bosnia%20and%20Herzegovina%20Report%202022.pdf>.
- 12 European Commission, *Kosovo 2022 Report*, 12 tetor 2022, 46, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>.
- 13 European Commission, *Albania 2022 Report*, 12 tetor 2022, 21, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Macedonia%202022.pdf>.
- 14 European Commission, *Montenegro 2022 Report*, 12 tetor 2022, 49, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Montenegro%20Report%202022.pdf>.
- 15 European Commission, *Serbia 2022 Report*, 12 tetor 2022, 52, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Serbia%20Report%202022.pdf>.
- 16 Leposava Bogić, *Advokat i çetiri klana, Vreme*, 5 maj 2022, <https://www.vreme.com/vreme/advokat-i-çetiri-klana/>.
- 17 Insajder, *Insajder otkriva detalje optužnice: Istraga i opstrukcija istrage protiv Šarića*, 29 janar 2023, <https://insajder.net/teme/insajder-otkriva-detalje-optuznice-istraga-i-opstruiranje-istrage-protiv-sarica>.
- 18 Po aty.
- 19 Jelena Jovanović, *Oduzeli četiri mobilna telefona u Zatvoru za duge kazne, Vijesti*, 11 shtator 2023, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/673117/oduzeli-çetiri-mobilna-telefona-u-zatvoru-za-duge-kazne>.
- 20 Jelena Jovanović, *Pronađeno šest mobilnih telefona i dva USB kabla u klima uređaju dostavljenom za zatvorenika u Spuzu, Vijesti*, 4 korrik 2023, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/663887/pronadjeno-sest-mobilnih-telefona-i-dva-usb-kabla-u-klima-uredjaju-dostavljenom-za-zatvorenika-u-spuzu>.
- 21 Vijesti, *Zaplijenjen dron, nadlijetao iznad spuškog zatvora sa dva telefona*, 20 janar 2023, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/639659/zaplijenjen-dron-nadlijetao-iznad-spuskog-zatvora-sa-dva-telefona>.
- 22 Jelena Jovanović, *'Voli vas brat': Mobilni telefoni pronađeni u specijalnom dnu šerpe koju je posjetilac krenuo da unese u zatvor, Vijesti*, 20 nëntor 2020, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/631422/voli-vas-brat-mobilni-telefoni-pronadjeni-u-specijalnom-dnu-serpe-koju-je-posjetilac-krenuo-da-unese-u-zatvor>.
- 23 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile, i cili drejton një organizatë që ofron mbështetje postpenale në Serbi, shtator 2023.
- 24 Vlada Crne Gore, *Biro za operativnu koordinaciju, SOCTA 2021: Procjena opasnosti od teškog i organizovanog kriminala u Crnoj Gori*, mars 2022, 18, <https://www.gov.me/dokumenta/cf105122-2c9b-4816-b152-8487b5f59063>.
- 25 Po aty.
- 26 Intervistë me drejtorin e një burgu në Maqedoninë e Veriut, shtator 2023.
- 27 Po aty.
- 28 U.S. Department of State, *2022 Country Reports on Human Rights Practices: North Macedonia*, shkurt 2023, 3, [https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610\\_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf).
- 29 U.S. Department of State, *2022 Country Reports on Human Rights Practices: Montenegro*, shkurt 2023, 5, [https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610\\_MONTENEGRO-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_MONTENEGRO-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf).
- 30 VOX News, *The director of the Reç-Shkodër prison is arrested*, 25 prill 2022, <https://www.voxnews.al/english/aktualitet/arrestohet-drejtori-i-burgut-rec-shkoder-i6997>.
- 31 Albanian Daily News, *Shkodra prison's warden suspended after report's forgery*, 12 janar 2022, <https://albaniandailynews.com/news/shkodra-prison-s-warden-suspended-after-report-s-forgery>.
- 32 Georgina Sturge, *UK Prison Population Statistics, House of Commons*, 8 shtator 2023, 14, <https://researchbriefings.files.parliament.uk/documents/SN04334/SN04334.pdf>.
- 33 *International treaty UK/Albania: Agreement on the Transfer of Sentenced Persons* [CS Albania No.3/2021], 19 tetor 2021, <https://www.gov.uk/government/publications/ukalbania>.



- agreement-on-the-transfer-of-sentenced-persons-cs-albania-no32021.
- 34 Ministry of Justice, *Government strikes deal to remove more Albanian prisoners*, 26 korrik 2021, <https://www.gov.uk/government/news/government-strikes-deal-to-remove-more-albanian-prisoners>.
  - 35 Ministry of Justice, *HM Prison and Probation Service and Alex Chalk KC MP, UK and Albania agree groundbreaking new arrangement on prisoner transfers*, 24 maj 2023, <https://www.gov.uk/government/news/uk-and-albania-agree-groundbreaking-new-arrangement-on-prisoner-transfers>.
  - 36 *They Work For You, Prisoners' Transfers: Albania, Ministry of Justice written question – answered on 4 September 2023*, <https://www.theyworkforyou.com/wrans/?id=2023-07-20.195373.h>.
  - 37 Intervistë me Ervin Karamuçon, profesor i kriminologjisë në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Tiranë, shtator 2023.
  - 38 Panorama, 'Britania përdor shqiptarët për të fituar kredo politike'- Juristi Ramaj tregon në 'Panorama TV': Marrëveshja për të burgosurit, propagandë në bashkëpunim me qeverinë tonë, 25 maj 2023, <http://www.panorama.com.al/britania-perdor-shqiptaret-per-te-fituar-kredo-politike-juristi-ramaj-tregon-ne-panorama-tv-marreveshja-per-te-burgosurit-propagande-ne-bashkepunim-me-qeverine-t/>; MCN TV, Transferimi i të dënuarve nga Britania, Petraj: Burgjet shqiptare nuk kanë kapacitete! Kodi penal nuk parashikon të njëjtën vuajtje dënimi, 24 mars 2023, <http://www.mcntv.al/2023/03/24/transferimi-i-t-d-nuarve-nga-britania-petraj-burgjet-shqiptare-nuk-kan-kapacitete-kodi>.
  - 39 Shihni traktatin në faqen: <https://www.justitsministeriet.dk/wp-content/uploads/2022/04/Final-treaty-Denmark-Kosovo.pdf>.
  - 40 N1 Belgrade, *Kosovo Justice Minister says millions from prison rental*, 23 dhjetor 2021, <https://n1info.rs/english/news/kosovo-justice-minister-says-millions-from-prison-rental/>.
  - 41 Charles Szumski, *Kosovo experts oppose Denmark prison outsourcing*, Euractiv, 22 dhjetor 2021, [https://www.euractiv.com/section/politics/short\\_news/kosovo-experts-oppose-denmark-prison-outsourcing/](https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/kosovo-experts-oppose-denmark-prison-outsourcing/).
  - 42 Koha, *Qeveria çon në Kuvend Traktatin me Danimarkën për burgjet*, 7 qershor 2023, <https://www.koha.net/arberi/380701/qeveria-con-ne-kuvend-traktatin-me-danimarken-per-burgjet/>.
  - 43 European Commission, *North Macedonia 2022 Report*, 12 tetor 2022, 16, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>; European Commission, *Albania 2022 Report*, 12 tetor 2022, 28, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>.
  - 44 European Commission, *Bosnia and Herzegovina 2022 Report*, 12 tetor 2022, 29, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Bosnia%20and%20Herzegovina%20Report%202022.pdf>.
  - 45 European Commission, *Kosovo 2022 Report*, 12 tetor 2022, 31, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>; European Commission, *Montenegro 2022 Report*, 12 tetor 2022, 35, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Montenegro%20Report%202022.pdf>; European Commission, *Serbia 2022 Report*, 12 tetor 2022, 36, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Serbia%20Report%202022.pdf>.

**Buletinet e Rreziqeve janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar prirjet e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme, dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse doni të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi regjistrohuni këtu ose dërgoni email në [Vanja.Petrovic@globalinitiative.net](mailto:Vanja.Petrovic@globalinitiative.net).**

### **MBI “INCIATIVËN GLOBALE”**

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 600 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përfaqësive inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

**[www.globalinitiative.net](http://www.globalinitiative.net)**

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL  
INITIATIVE**  
AGAINST TRANSNATIONAL  
ORGANIZED CRIME